REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TË ARDHURAVE,LEJAVE,LIÇENSAVE DHE BORXHIT

Nr._____Prot . **Bilisht, më / /2025**

PROJEKT-VENDIM
NR 83 /DATË 19 / 12 /2025

"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË APELIMIT ADMINISTRATIV TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PRANË BASHKISË DEVOLL DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SÉ FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZMIT TË KËTIJ KOMISIONI "

Bazuar në nenin 8, 9 pika 1/1.1 "a" dhe "b", nenit 33/1 "ç", nenit 54 "k", dhe 55/2-6 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit 44/2015 "Kodi i Proçedurave administrative", Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; VKM nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë ngritjen e Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Devoll dhe të miratojë rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas dokumentit bashkangjitur.

PROPOZOJ:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Devoll.

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.web.http://bashkiadevoll.gov.al/

2. Miratimin e rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Juridike Prokurimit dhe Zbatimit të Kontratave , Drejtoria e të Ardhurave Lejave, Licensave dhe Borxhit, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Territorit. Drejtoria e Urbanistikës

4. Ky vendim do të hyje ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55 pika6 te ligjit nr 139-2015 date 17.12.2025 "Per vetëqeverisjen vendore "I ndryshuar.

Konceptoi:
Drejtori i të Ardhurave, Lejave,Liçensave dhe Borxhit

Bledar Kanina

Konfirmoi bazën ligjore:
Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm

Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE DEVOLL
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TË ARDHURAVE LEJAVE LICENSAVE DHE BORXHIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE PROKURIMIT DHE ZBATIMIT TË KONTRATAVE

Nr. 4275 **Prot.** **Datë** 19 /12/**2025**

RELACION

PËR

" NGRITJEN E KOMISIONIT TË APELIMIT ADMINISTRATIV TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PRANË BASHKISË DEVOLL DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZMIT TË KËTIJ KOMISIONI"

Në Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshimet ligjore të pësuara,neni 7 parashikon se taksapaguesit kanë të drejtën të paraqesin ankim në nivel vendor kundër vendimit, veprimit apo mosveprimit të zyrës së taksave dhe tarifave vendore. Ankimi i taksapaguesit bëhet tek Struktura Vendore e Apelimit Tatimor, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga Këshilli Bashkiak. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative kundër vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor .

Në këto kushte lind nevoja e ngritjes të Komisionit të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni, kompetencat, detyrat, veprimet që duhet të ndërmarrë ky Komision, kjo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu, hartimi i kësaj rregulloreje i referohet edhe parashikimeve të Ligjit nr. nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe enteve publike".

Sa më lart relatuam bazuar në nenin 8, 9 pika 1/1.1 "a" dhe "b", nenit 33/1 "ç", nenit 54 "k", dhe 55/2-6 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit 44/2015 "Kodi i Proçedurave administrative", Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; VKM nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën

dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë ngritjen e Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Devoll dhe të miratojë rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Komisionit të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas dokumentit bashkangjitur.

Konceptoi:

Drejtor i të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit

Bledar Kanina

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË APELIMIT ADMINISTRATIV TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

NENI 1
KOMISIONI APELIMIT TII TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

1. Pranë Bashkisë Devoll ngrihet dhe funksionon Komisioni i Apelimi të Taksave dhe Tarifave Vendore, më poshtë dhe në vijim do të quhet Komisioni i Apelimit.

2. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me ankesat administrative të praqitur nga tatimpaguesit në lidhje me taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Devoll.

3. Komisioni i Apelimit përbëhet nga 5 anëtarë, me përbërje si më poshtë:

a. Një zëvendës kryetar i Bashkisë;

b. Nje përfaqësues të Drejtoria e Shërbimeve Juridike Prokurimit dhe Zbatimit të Kontratave;

c. Një përfaqësues i Drejtorisë së Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit;

d. Një përfaqësues nga Drejtoria e Urbanistikës

e. Një përfaqësues nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Territorit

4 Anëtarët e Komisionit të Apelimit, si rregull duhet të jenë të diplomuar si dhe të kenë të paktën tre vjet përvojë në profesion apo administratën publike.

5 Komision i Apelimit ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, me një mandate 1 vjeçar me të drejtë riemërimi brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

6 Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 7 ditëve punë nga hyrja në fuqi e urdhërit të Kryetarit të Bashkisë. Në mbledhjen e parë, Komisioni I Apelimit zgjedh kryetarin dhe sekretarin administrativ.

7 Për funksionin e kryetarit të komisionit propozohen të paktën dy kandidatura alternative. Kryetari zgjidhet kandidati që merr të paktën 3 vota.

8 Në rast se nuk arrihet zgjedhja e kryetarit, pasi asnjëri nuk merr votat e mjaftueshme, edhe pas raundit të dytë të votimit, atëherë ata emërohen me urdhër të kryetarit të Bashkisë.

9 Me propozim të kryetarit, komisioni i apelimit zgjedh nga radhët e anëtarëve sekretarin administrativ.

10. Kryetari dhe anëtarët e komisionit mund të ndryshohen në çdo kohë me urdhër të kryetarit të Bashkisë, në rastet kur:

a. nuk marrin pjesë në tri mbledhje radhazi të komisionit, pa shkaqe të justifikuara;

b. japin dorëheqjen;

c. janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacioni në fuqi

d. përfundojnë marrëdhënien e punës me bashkinë;

e. bëhen të paaftë nga ana shëndetësore për të kryer funksionet e ngarkuara;

11. Komisioni i Apelimit asistohet nga një sekretariat teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të Drejtorise të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit. Ata duhet të jenë diplomuar në shkencat ekonomike ose juridike, të kenë njohuri të mira, në nivel teknik, për legjislacionin tatimor, si dhe të kenë të paktën, 2 vjet përvojë pune në administratën tatimore.

NENI 2
KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT

1.Kryetari i Komisionit i cili është një nga anëtarët, ushtron këto detyra:

- **a.** cakton datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së komisionit dhe vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje;
- **b.** drejton zhvillimin e mbledhjeve të komisionit;
- **c.** mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit të komisionit;
- **d.** cakton anëtarin/anëtarët që do të relatojnë ankimin për shqyrtim nga Komisioni në mbledhjen e radhës;
- **e.** raporton për ecurinë e veprimtarisë së Komisionit prane Kryetarit të Bashkisë brenda muajit dhjetor të çdo viti ose sa herë i kërkohet prej tij;
- **f.** ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
- **g.** nënshkruan vendimet e Komisionit, në përputhje me parashkimet e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Anëtarët e Komisionit ushtrojnë këto detyra:

- **a.** marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit dhe njoftojnë drejtuesin e mbledhjes për mosparaqitjen e tyre dhe arsyet e mungesës;
- **b.** votojnë për çështjet e rendit të ditës, bazuar në parimin e profesionalitetit dhe ndershmërisë;
- **c.** deklarojnë në mbledhjen e radhës, para votimit të çdo çështjeje, nëse janë në kushtet e konfliktit të interesit;
- **d.** secili prej anëtarëve relaton para komisionit çështjen e caktuar;
- **e.** ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
- **f.** nënshkruajnë vendimet e Komisionit, në përputhje me parashkimet e Kodit të Procedurave Administrative.

3.Sekretariati administrativ i Komisionit ushtron këto detyra:

- **a.** merr në dorëzim ankimet që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit;
- **b.** shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- **c.** njofton kryetarin e komisionit për çdo ankimim të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të ankimit;

d. njofton ankimuesin të paktën 7 ditë pune përpara për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit.
e. mban dhe harton procesverbalin e mbledhjes;
f. zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit.
g. Ruan konfidencialitetin

Komisioni gjatë shqyrtimit të një ankimi ka të drejtë të kërkojë nga palët çdo informacion shtesë, ose të dhëna plotësuese që i gjykon të nevojshme, si dhe ka të drejtë të bëjë verifikime, në funksion dhe për qëllime të shqyrtimit të ankimit.

NENI 3
ORGANIZIMI, PROCEDURA DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE

1. Komisioni mblidhet me kërkesë të ose të paktën të 2 anëtarëve të tij, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankimit.
2. Rendi i dites dhe data e mbledhjes caktohet nga kryetari dhe u njoftohet anëtarëve të komisionit nëpërmjet sekretariatit, të paktën shtatë ditë pune përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.
3. Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë të komisionit. Kur kjo shumicë nuk është arritur, caktohet një datë tjetër, brenda tri ditëve pune.
4. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë, çdo anëtari dhe ankimuesi apo përfaqesuesi i tij. Komisioni mund të mblidhet më shumë se një herë për të njëjtën çështje sipas nevojës.
5. Vendimet në çdo rast merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje. Komisioni merr vendime vetëm për kërkesa për apelim, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
6. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal me shkrim, i cili përmban një përmbledhje të gjithë procesit, por pa u kufizuar në, opinione të anëtarëve, datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimi, vendimet që u morën, si dhe rezultati i votimeve.
7. Procesverbali mbahet nga sekretariati dhe duhet të paraqitet për nënshkrim nga të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillimin e mbledhjes pasardhëse.

NENI 4
OBJEKTI I APELIMIT

1. Është objekt ankimi pranë Komisionit të Apelimit çdo akt administrativ apo mosveprim nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për nxjerrjen e një akti administrativ në lidhje me një taksë dhe/ose tarifë vendore. Për këtë qëllim, akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet e nxjera nga Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit që shkaktojnë efekte financiare dhe/ose ligjore në mënyrë individuale për çdo taksapagues.

2. Vendimet administrative që mund të ankimohen lidhur me taksapaguesin dhe detyrimin e tij tatimor përfshijnë:

a) çdo njoftim vlerësimi apo çdo akt tjetër administrativ që ndikon detyrimin tatimor të taksapaguesit;

b) gabimet në llogaritjen e përqindjes së kamatëvonesës;

c) vendosjen ose gabimet në llogaritjen e shumave dhe llojeve të gjobave.

d) përllogaritja e taksave dhe tarifave vendore, e.t.j të ngjashme me to

3. Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi, të Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit (p.sh. një akt që nuk është miratuar nga Bashkia Devoll apo Këshilli Bashkiak brenda periudhës së përcaktuar në ligj, pavarësisht nëse taksapaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të.

4. Është objekt ankimi çdo akti administrativ i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë, për qëllime të taksës së ndërtesës.

5. Ankimi mund të bëhet nga taksapaguesi apo nga përfaqësuesi i tij. Në qoftë se administrata tatimore vendore ka nxjerrë disa vendime administrative lidhur me të njëjtin taksapagues, taksapaguesi mund të apelojë dy vendime apo akte në të njëjtin apelim kur ato plotësojnë kërkesat për apelim në bazë të rregullores së hartuar bazuar në këtë rregullore.

6. Gjatë procedurës së ankimit, Komisioni i Apelimit, ka të drejtë të grupojë së bashku disa ankime me qëllim të maksimizimit të efiçiencës në procedurën e ankimit.

7. Aktet e Komisionit të Apelimit, që rezultojnë nga procedura e ankimit NUK mund të jenë objekt ankimi administrativ. Këto vendime MUND të ankimohen vetëm në gjykatë.

NENI 5

ANKIMI NDAJ VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME "NDËRTESË"

1.Çdo subjekt taksapagues për qëllim të vlerës së taksës së ndërtesës, pas marrjes së njoftimt të detyrimit për taksën e pasurisë (ndërtesës), kanë të drejtë të kundërshtojnë administrativisht vlerësimin e bërë nga autoritetet përkatëse të vlerës/sipërfaqes së pronës për kategorinë ndërtesë. Një kërkesë ë tillë mund të paraqitet edhë në rastet kur ankuesi gjykon se ndërtesa e tij është objekt përjashtimi nga ligji.

2. Fillimisht subjekti paraqet një kërkesë për korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit të ndërteses dhe çmimeve përkatëse.

3. Taksapaguesi, ka të drejtë në çdo kohë, të kërkojë korrigjimin e detyrimit. kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë nuk është bërë në përputhje me parashikimet e VKM nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" apo kur ky vlerësim ka pasaktësi sa i takon të dhënave të përdorura.

4. Kërkesa për korrigjimin e vlerës për taksën e pasurisë depozitohet në Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit , në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme "ndërtesë", të shoqëruar dhe me dokumentacionin justifikues

5. Për të disiplinuar dhe unifikuar procedurat e korrigjimit, taksapaguesit plotësojnë një formular tip sipas modelit që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi ne Aneksin 1 dhe që bëhet pjesë e Rregullores.

6. Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit dhe vendos:

1. Të pranojë kërkesën për korrigjim dhe bën korrigjimin e vlerës nëse vlerësimi fillestar është bazuar mbi të dhëna të gabuara apo ka gabime në përllogaritje;
2. Të refuzojë kryerjen e korrigjimit dhe arsyeton me vendim arsyet e refuzimit të kërkesës për korrigjim.

7. Taksapaguesi ka të drejtë që nëse nuk është dakord me vendimin e Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit ne lidhje me kërkesën e tij për korrigjim, të ankimojë këtë vendim pranë Komisionit të Apelimit.

8. Nëse taksapaguesi nuk është dakort me vendimin e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me kërkesën për korrigjim ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Komisionin e Apelimit brenda një afati prej 30 ditësh nga data kur është marrë apo konsiderohet i marrë njoftimi.

9. Së bashku me ankimin, taksapaguesi dorëzon dokumentacionin me të cilin vërteton pretendimet e tij, brenda afatit prej 30 ditësh prej datës kur është marrë apo konsiderohet të jetë marrë njoftimi për vendimin e Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit ndaj kërkesës për korrigjim.

10. Kanë të drejtë të paraqesin ankim pronarët e ndërtesës apo përdoruesit e saj, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" dhe zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të përfundojnë ndërtimin brenda afateve të përcaktuara në lejen përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit.

11. Taksapaguesi mund të parashtrojë ankim për taksën mbi pasurinë e paluajtshme/ndërtesë pasi vlerësimi i taksës së pasurisë nuk është i drejtë si rezultat i:

1. Të dhënave të pasakta;
2. Vendndodhjes së pasurisë dhe çmimeve përkatëse,
3. Normës tatimore të pasaktë, bazuar në qëllimin e përdorimit të pasurisë
4. Dhe çdo arsye tjetër që ndikon ne detyrimin e tij tatimor.

12. Komisioni i Apelimit, në lidhje me ankimin e vlerësimit të pasurisë së paluatjshme/ndërtesë kryen këto detyra:

a. Planifikon dhe mban mbledhje të rregullta për shqyrtimin e ankimimeve, brenda periudhës 30 ditore, nga dita e pranimit të ankimimeve;
b. Mund të kërkojë praninë e ankimuesit, për dëgjim para kësaj Strukture për të sqaruar arsyen e ankimit dhe për të sjellë çfarëdo dokumenti apo prove që mund ta mbështesë ankimin;
c. Mund të kërkojë të dhëna nga Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit apo nga zyra e agjentit për mbledhjen e taksës;
d. Mund të inspektojë pronën e paluajtshme, kur vlerësohet se një veprim i tillë është në shërbim të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

13. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioni i Apelimit vendos:

a. Refuzimin e ankimin për shkak se e konsideron të papranueshëm për mungesë të kritereve formale të përcaktuara në këtë rregullore;
b. Lënë në fuqi aktin administrativ objekt apelimi;
c. Shfuqizimi e aktit administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë pranë ministrisë përgjegjëse për financat për të reflektuar ndryshimet në Regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme (Kadastër);
d. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë pranë ministrisë përgjegjëse për financat për të reflektuar ndryshimet në Kadastër.

14. Proçedura e korrigjimit nuk kushtëzon me ndonjë detyrim nga ana e taksapaguesit për të paguar taksën për të cilën është bërë kërkesa për korrigjim.

15. Nëse taksapaguesi përsëri nuk bie dakort me vendimin e dhënë nga Komisioni i Apelimit, ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

NENI 6
ANKIMIMI NDAJ AKTEVE ADMINISTRATIVE APO MOSVEPRIMIT ADMINISTRATIV NGA DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

1.Taksapaguesi ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Apelimit:

a. Çdo akt administrativ të Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit;
b. Veprimin apo mosveprimin e Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit dhe ky veprim apo mosveprim ka të bëjë me taksapaguesin dhe ndikon në detyrimin e tij të taksave dhe tarifave vendore.

NENI 7
AKTET QË NUK MUND TË ANKIMOHEN NË KOMISIONIN E APELIMIT

1.Aktet që nuk mund të ankimohen pranë Strukturës (Drejtorisë ose Komisionit të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë:

a. Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që nuk ndikojnë në detyrimin tatimor vendor të taksapaguesit;
b. Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që shkelin të drejtat e tatimpaguesve sipas Ligjit "Për procedurat tatimore";
c. Masat administrative të mbledhjes me forcë të detyrimeve.

2. Në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI të Ligjit "Për procedurat tatimore", i ndryshuar masat administrative të parashikuara sipas këtij kreu dhe në kapituj të tjerë të këtij ligji, që kanë të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apelimi administrativ pranë Komisionit të Apelimit.

NENI 8
ANKIMI NDAJ BARRËS SIGURUESE APO HIPOTEKORE

1.Pavarësisht parashikimit të nenit 7, taksapaguesi ndaj pasurisë së të cilit, ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, në formën e barrës siguruese apo hipotekore, ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit, vetëm në ato raste kur zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt.

2.Konsiderohet se ekzekutimi i vendimit për marrjen e masave të sigurisë nuk është kryer në rregull në rastet e mëposhtme:

a) kur taksapaguesi nuk ka pasur njoftim me shkrim për sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore të parashikuara nga Ligji "Për procedurat tatimore";
b) kur gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij, detyrimi tatimor vendor është paguar;
c) nëse pasuria e vendosur si barrë siguruese apo hipotekore, është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk mund të shtrihet ekzekutimi sipas nenit 529 te Kodit te Procedurës Civile;
d) kur akti me anë të të cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin për mbledhjen me forcë të taksave dhe tarifave vendore ka dalë jo në emër të taksapaguesit por kundrejt një personi tjetër. Akti administrativ i konfiskimit i mbajtur sipas nenit 122 pika 4 të ligjit "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, edhe pse nuk është objekt i apelimit pranë Komisionit të Apelimit, në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative ankimohet administrativisht tek Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit.

3.Taksapaguesi, në rast se ka konstatuar parregullsi në ekzekutimin e vendimit, e ushtron të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të tyre.

4.Në çdo rast, në ankesën e tij taksapaguesi është i detyruar t'i provojë Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit momentin se kur ai ka marrë dijeni për një parregullsi, gjë e cila duhet të provohet vetëm me anë të provave shkresore.

5. Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit në përfundim të shqyrtimit, brenda 30 ditëve kalendarike prej marrjes së kërkesës, vendos:

a. Të refuzojë kërkesën nëse nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga data e konstatimit të parregullsisë;
b. Të lërë në fuqi vendimin e masës siguruese, barrë siguruese apo barrë hipotekore. Kundër këtij vendimi, taksapaguesi mund të ankimojë këtë vendim në përputhje me këtë Rregullore tek Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore;
c. Të shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht vendimin e masës siguruese, barrë siguruese apo barrë hipotekore.

NENI 9
DORËZIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV

A. Kriteret formale të ankimit

1.Ankimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë. Njoftimi konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi brenda 10 ditëve kalendarike mbas pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Në rastet kur dita e fundit e afatit bie ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

2. Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit gjykon që taksapaguesi e merr njoftimin që i dërgohet brenda shtatë ditëve kalendarike pas ditës së dërgimit. Data e dërgimit konsiderohet data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar.

3.Në rastet kur në aktin administrativ mungon njoftimi që informon taksapaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshirë afatin dhe të drejtën e apelimit, taksapaguesi mund të ankimojë brenda tre muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë.

4. Në rast mosveprimi të administratës tatimore (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas ditës së dorëzimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ.

5. Në qoftë se ankimi pranë Komisionit të Apelimit nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

6.Taksapaguesi mund të kërkojë rivendosjen në afat vetëm nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme respektimi i afatit procedural. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15

ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet dorëzuar edhe ankimi pranë Komisionit të Apelimit.

7. Ankimi duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimuesi. Gabime jo materiale, ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmërinë apo thelbin, të cilat nuk cënojnë mundësinë e trajtimit efikas të apelimit, nuk përbëjnë arsye për mos-marrjen në shqyrtim të apelimit. Ankimi dorëzohet pranë zyrës së protokollit të Bashkisë drejtpërdrejtë nga taksapaguesi ose nëpërmejt shërbimit postar.

8. Dokumentacioni shoqërues që i bashkëngjitet ankimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **a.** emrin dhe adresën e taksapaguesit,
- **b.** numrin e regjistrimit të taksapaguesit (NUIS), (ID)
- **c.** aktin administrativ, të nxjerrë ose të panxjerrë nga organi tatimor, që është objekt ankimi duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor,
- **d.** pagesën ose jo (në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak) të detyrimit tatimor që ankimohet,
- **e.** arsyet për ankimin e tij,
- **f.** informacion në mbështetje të ankimit (Aktin e kontrollit, proces-verbalet, etj.)
- **g.** çdo dokument tjetër që ankimuesi e gjykon të rëndësishëm,
- **h.** nënshkrimin e tij.

9. Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura në paragrafët (i) deri në (iv) më lart, Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike.

10. Taksapaguesi nuk mund te apelojë në gjykatë një akt administrativ që është objekt ankimimi në Komisionin e Apelimit, pa pasur një Vendim të këtij komisioni lidhur me këtë akt administrativ.

11. Në rast kur Komisioni i Apelimit nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, taksapaguesi mund të ankimojë aktin drejpërdrejt në gjykatë.

NENI 10
PAGESA E DETYRIMIT TË ANKIMUAR

1.Në përputhje me Nenin 5, pika ç,v),te Ligjit 9632 " Për Sistemin e Taksave Vendore", dhe vendimmarjes të Këshilli Bashkiak, ankimi pranohet në qoftë se ankimuesi:

a.parapaguan shumën e plotë/pjesshëm të detyrimit tatimor, objekt ankimi të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet, ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht

6 muaj, por jo më pak se afati sipas të cilit vendimi merr formë të prerë për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimor;

b.vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi ose të garancisë bankare.

2.Taksapaguesi pajiset nga Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit me urdhër pagesë ku pasqyrohen saktësisht tatimi i pagueshëm.

3.Në qoftë se taksapaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

4.Taksapaguesi nuk mund te apelojë në gjykatë një akt administrativ që është objekt ankimimi në Komisionin e Apelimit pa pasur një Vendim të kësaj Strukture lidhur me këtë akt administrativ.

5.Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura më lart, Komisioni i Apelimit i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike.

NENI 11
VENDIMI DHE ARSYETIMI NGA KOMISIONI I APELIMIT

1. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga taksapaguesit. Ajo i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore.
2. Komisioni i Apelimit mund të kërkojë informacion shtesë, p.sh. dokumente të tjera nga taksapaguesi, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga palë të treta, si dhe mund të kërkojë ose të bëjë verifikime që ndihmojnë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes.
3. Komisioni i Apelimit kufizon shqyrtimin e ankimit vetëm për çështjet e ngritura nga taksapaguesi në ankim. Komisioni mund të marrë masa të tjera për qartësimin e fakteve, p.sh. ata mund të takohen me ankimuesin për qartësimin e fakteve.
4.Në qoftë se gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë se detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Komisioni i Apelimit nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor. Në këtë rast Komisioni i dërgon shkresë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me të cilën e vë në dijeni për rrethanat e reja të lindura gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ.

5. Komisioni i Apelimit ka të drejtë të shqyrtojë dhe anullojë gjoba, plotësisht apo pjesërisht, panvarësisht nga vlefshmëria e detyrimit tatimor, në rastet e parashikuara në përputhje me nenin 111 të Ligjit "Për procedurat tatimore" i ndryshuar. Ky gjykim bazohet në analizimin e plotë të arsyeve që kanë shkaktuar dhe rrethanave në të cilat është kryer shkelja, duke evidentuar faktet dhe argumentet mbi bazën e të cilave bëhet gjykimi dhe merret vendimi.

6. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes Komisioni i Apelimit vendos:

a. Të refuzojë ankimin për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm;
b. të rrëzojë ankimin;
c. të anulojë aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose
d. të pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe të ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.

7.Vendimi i Komisionit të Apelimit, duhet të përfshijë një shpjegim me shkrim të bazës së tij, duke përfshirë mënyrën e arsyetimit si parashikohet në nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative. Vendimi duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Apelimit.

8. Arsyetimi duhet të jetë:

a. I qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsyetimi është bërë në informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar. Në këto raste informacionet dhe propozimet janë pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar;

b. Vendimi përmban një dispozitë që vë në dijeni taksapaguesin për të drejtën e tij për ankimin e vendimit në gjykatë dhe i dërgohet taksapaguesit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ka bërë vlerësimin ose ka nxjerrë vendimin objekt ankimi.

c. Përdorimi për arsyetim i të dhënave të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme.

9.Komisioni i Apelimit pas shqyrtimit të çështjes vendos:

i. Të refuzojë ankimin për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm;
ii. Ta rrëzojë ankimin;
iii. Ta anulojë aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose
iv. Ta pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe ta ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.

10. Komisioni i Apelimit e rrëzon një ankim në qoftë se:

a. gjykon që ankimi është i pabazuar pasi procedura është ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka qenë i drejtë dhe ligjërisht korrekt, ndërsa ankimi është i pabazuar.

b. zbulon që ka pasur mosveprime (ose gabime të administratës tatimore), por që ato kanë qenë aq të parëndësishme sa që nuk mund ta kenë ndikuar vendimin e administratës tatimore.

c. akti administrativ është bazuar në ligj por për arsye të tjera nga ato të shprehura në akt, ajo shpjegon këto arsye në vendim.

11. Komisioni i Apelimit plotëson procedurën dhe eliminon mungesat vetë ose mund t'ia kërkojë këtë gjë Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit në qoftë se:

a. Konstaton që faktet në procedurë janë përcaktuar me mungesa dhe gabime;

b. Konstaton që procedura nuk ka mbajtur parasysh rregullat procedurale që mund të kenë ndikuar aktin administrativ; ose,

c. Konstaton që përmbajtja e aktit administrativ të kundërshtuar është e paqartë ose bie ndesh me shpjegimet e tij.

12. Komisioni i Apelimit në bazë të fakteve të vërtetuara gjatë procedurës, vendos anullimin e aktit administrativ dhe vendos vetë për çështjen ose i kërkon Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit ta zgjidhë atë nëse konstaton që Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit:

a. I ka vlerësuar provat gabimisht;

b. Ka nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet e parashtruara;

c. Ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi është zbatuar gabimisht; ose,

d. Komisioni i Apelimit është i mendimit që duhej marrë një vendim i ndryshëm nga ai i marrë.

13. Ankimuesi mund të heqë dorë nga ankimi para nxjerrjes së vendimit të ankimit. Në qoftë se taksapaguesi heq dorë nga ankimi, procedura e ankimit ndërpritet me një vendim për mbylljen e procedurës së ankimit. Heqja dorë nga një ankim nuk i heq të drejtën taksapaguesit për të ankimuar përsëri me kusht që ankimi të bëhet brenda afatit të caktuar.

NENI 12
AFATI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT NGA KOMISIONI I APELIMIT

1.Komisioni i Apelimit vendos për ankimin brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së ankimit.

2. Në qoftë se dita e fundit e këtij afati bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës. Në qoftë se ankimi nuk përmbush formalitetet e përcaktuara në këtë rregullore, afati 60-ditor fillon një ditë pas plotësimit të kërkesave formale nga ankimuesi por jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas marrjes së ankimit.

3. Në asnjë rast koha e shqyrtimit të ankimit nga Komisioni i Apelimit nuk mund të kalojë 90 ditë duke filluar nga data e marrjes së ankimit.

4. Kur Komisioni i Apelimit nuk nxjerr vendim brenda brenda 60 ditësh nga marrja e ankimit të plotësuar si duhet, taksapaguesi mund të fillojë një ankim gjyqësor edhe në mungesë të vendimit të Komisionit të Apelimit.

5.Në qoftë se vendimi i ankimit varet plotësisht ose pjesërisht nga një çështje e mëparshme që është subjekt i procedurave gjyqësore ose është nën juridiksionin e një organi tjetër publik,

Komisioni i Apelimit mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çështjes së mëparshme.

6. Në rastin e pezullimit të një procedure, vendimi përfundimtar i Komisionit të Apelimit duhet të nxirret brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së ankimit të plotësuar si duhet. Përndryshe ankimuesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë.

NENI 13
ANKIMI KUNDËR VENDIMIT TË KOMISIONIT TË APELIMIT

1.Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë ankimim në rrugë gjyqësore kundër vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi.

2 Në qoftë se taksapaguesi nuk është njoftuar korrektësisht ose nuk është njoftuar fare për të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e Komisionit të Apelimit, ankimi në gjykatë duhet të bëhet brenda tre muajsh nga data kur vendimi është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë.

3.Mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore në mungesë të një vendimi të Komisionit të Apelimit evetëm në qoftë se:

- **a.** Akti administrativ nuk përfshihet në objektin e apelimit sipas kësaj rregulloreje; ose,
- **b.** Komisioni i Apelimit nuk nxjerr vendim brenda 60 ditësh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet, ose në rast pezullimi, nuk nxjerr vendim brenda gjashtë muajsh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet.

4. Ankimi në rrugë gjyqësore nga ankimuesi pranohet vetëm në qoftë se ankimuesi ka qenë pjesërisht ose plotësisht i pasuksesshëm në ankimin e tij administrativ sipas vendimit të Komisionit të Apelimit. Për një akt administrativ objekt ankimi nuk mund të kapërcehet faza e ankimit administrativ dhe të bëhet ankim drejtpërsëdrejti në gjykatë.

NENI 14
RIMBURSIMI I DETYRIMIT TATIMOR VENDOR, KAMATËVONESËS DHE/ OSE GJOBËS NE RASTET E PARAPAGIMIT NË PROCESIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV

1.Nëse vendimi i Komisionit të Apelimit është në favor të taksapaguesit, detyrimi i parapaguar nga taksapaguesi dhe kamatëvonesat llogaritura nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimbursimit, i rimbursohen taksapaguesi brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi i Komisionit të Apelimit.

2.Nëse taksapaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të Komisionit të Apelimit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi.

3.Nëse Komisionit të Apelimit, lë në fuqi vendimin e Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit dhe taksapaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin taksën apo

tarifën, në rastin kur nuk është paguar, ose është vendosur garanci, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga taksapaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë.

NENI 15
EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË KOMISIONIT TË APELIMIT DHE APELIMI NË GJYKATË

1.Vendimi i Komisionit të Apelimit, ekzekutohet pas njoftimit të këtij vendimi.
2. Nëse taksapaguesi nuk është dakort me këtë vendim të Komisionit të Apelimit, mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.
3.Nëse Komisioni i Apelimit nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatë.